



---

**VENDIM**  
**Nr. 18 Datë 26.02.2010**

**PËR**  
**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË**  
**“DOSKU - ENERGY” SH.P.K.**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 gërma “a”, 9 dhe 13 pika 1, gërma “a”, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma “a”, 8 pika 4 dhe 10 pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, nenit 18, pika 1, gërma “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 26.02.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Dosku –Energy“ sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, te kesaj shoqërie,

**Konstatohet se:**

Aplikimi i shoqërisë “Dosku Energy” sh.p.k plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshem dhe rinovimit të licensave si më poshtë:

- o Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germa “a”, “b” dhe “c” është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- o Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gërma “a”, “b”, “c”, “d”, “f” dhe “g” është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte. *(ne kontraten koncesionare percaktohet se Organi Shteteror i Autorizuar merr persiper te kryeje proceduren e shpronesimit sipas legjislacionit ne fuqi, pas paraqitjes se dokumentacionit te nevojshem per shpronesim nga Koncesionari)*
- o Dokumentacioni finaciar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa “a”, “b” dhe “d” janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- o Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4) eshte plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGIJË**  
Bordi i Komisionerëve



---

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurat për licensimin e shoqërisë “Dosku - Energy” sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hidrocentrali “Gizavesh”.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari i ERE-s**  
**Bujar Nepravishta**

REPUBLIKA E SHQIPERISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
Bordi i Komisionerëve



---

Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

**VENDIMIN**

*Nr. 18 Datë 26.02.2010*

**PËR**

**FILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË  
“DOSKU - ENERGY” SH.P.K.**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
<b>Bujar Nepravishta</b>	_____	_____
<b>Entela Shehaj</b>	_____	_____
<b>Ardian Haçi</b>	_____	_____
<b>Abaz Aliko</b>	_____	_____

**Shkëlqim Bozgo**

---

---

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta" Nr.10  
Tirane  
E-mail [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al)

Tel/Fax +355 42 22 963  
Tel +355 42 69 590  
[www.ere.gov.al](http://www.ere.gov.al)